



Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

Kerkese per informacion Nr. Prot 162/23

2332

info app <info@app.gov.al>

Thu, Nov 16, 2023 at 3:25 PM

To: "qendra.respublica@gmail.com" <qendra.respublica@gmail.com>

Lidhur me sa keni kërkuar, ju sqarojmë se:

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") i ushtron detyrat në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" (në vijim "LPP").

Në nenin 23/d/e të këtij ligji përcaktohet se: "APP për përmbushjen e detyrave të saj kryen këto funksione:

d) verifikon zbatimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit ose anulimit të procedurës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore;

e) në rast shkeljesh të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, vendos gjopa sipas parashikimeve të këtij ligji ose i propozon drejtuesit të autoritetit ose entit kontraktor apo organeve më të larta masa disiplinore për personat e autoriteteve ose enteve kontraktore, që i kanë kryer këto shkelje".

Referuar dispozitave të mësipërme, sjellim në vëmendje se, APP është organ administrativ që verifikon nga pikëpamja procedurale zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit ose anulimit të procedurës.

Në rast se konstatohen shkelje të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, APP vendos masat përkatëse administrative, gjobë ose propozim mase disiplinore, sipas parashikimeve të nenit 132 të LPP.

Të dhëna në formë të përmbledhur (numër, datë, autoriteti/enti kontraktor subjekt i hetimit, numri dhe lloji i procedurave të prokurimit të hetuara, gjetjet kryesore, masat e marra administrative) mbi vendimet e marra nga APP në përfundim të hetimeve administrative, gjenden të publikuara në faqen e saj zyrtare të internetit, në rubrikën "Transparenca", të aksesueshme nga çdo i interesuar.

Gjithashtu, në raportin vjetor të veprimitarisë së APP, publikuar në faqen e saj zyrtare, gjeni ndër të tjera, të dhëna mbi verifikimet e kryera.

Ndërkohë, në lidhje me sa është kërkuar, bëjmë me dije se, nuk ka patur raste të kallëzuara në prokurori nga APP, për vitin 2022.

Njëkohësisht, bëjmë me dije se, në çdo rast të paraqitjes së denoncimeve nga të tretë lidhur me zhvillimin e procedurave të prokurimit, të cilat duhet të jenë të argumentuara dhe të dokumentuara, për pretendime që shkojnë përtej hetimit administrativ, APP u rekomandon denoncuesve t'u drejtohen organeve kompetente.

Sikurse është sqaruar edhe më sipër, APP heton administrativisht zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Duke ju falenderuar,

Agjencia e Prokurimit Publik
Blv "Dëshmorët e Kombit", pranë Këshillit të Ministrave
Tiranë, Albania

Tel. +355 42 2 77 510